

Drejtuar: AKM-se Tirane
Per dijeni: DRM-se Tirane

KERKESE PER KONSULTIM ME PUBLIKUN LABORATOREVE KLINIK- BIODIMIK, MIKROBIOLOGJIK, HORMONAL DHE GJENETIKE



Bazuar ne shtojcen 1 te ligjit Nr. 52/2020 per disa ndryshime ne ligjin Nr. 10 448, date 14.7.2011, "Per lejet e mjedisit", te ndryshuar klasifikohet si aktivitet:

*Veprimtari te tjera, ID 12.3 Institucionet shendetesore
Çdo prodhues i mbetjeve spitalore i cili prodhon me shume se 200 kg/vit mbetje spitalore te rrezikshme Kapaciteti kufi per lejet e tipit B*

Vendodhja: Rrugen Tish Daija, Kompleksi Kika 2, Tirane.

Zhvilluesi:
Shoqeria "Labor Dr. Limbach Heidelberg Germany"sh.p.k



Sokol Agaraj
Administrator

Maj 2022

Hyrje

Kerkesa per pjesmarrjen ne organizimin e konsultimit me publikun dhe palet e interesuara hartohet per aplikim per leje mjdisi tipi B,

Veprimtari te tjera, ID 12.3 Institucionet shendetesore


Kapaciteti kufi per lejet e tipit B Çdo prodhues i mbetjeve spitalore i cili prodhon me shume se 200 kg/vit mbetje spitalore te rrezikshme, bazuar kjo ne shtojcen 1 te ligjit Nr. 52/2020 per disa ndryshime ne ligjin Nr. 10 448, date 14.7.2011, “Per lejet e mjedisit”, te ndryshuar.

Ky aktivitet zhvillohet nga shoqeria “Labor Dr. Limbach Heidelberg Germany”sh.p.k e regjistruar ne QKB, me numer NUIS M02004008I me aktivitet ne fushen e shendetesise si qender diagnostikuese mjeksore, krijim i laboratoreve klinik- biokimik, mikrobiologjik, hormonal dhe gjenetike, etj.


Aktiviteti eshte instaluar ne nje siperfaqe 420 m², shkalla 8. Ap. 01 prane kompleksit Kika 2, ne zone kadastrale Nr. 8380, rruga “Tish Daija”.

Ambjenti ku jane instaluar pajisjet laboratorike te realizmit te analizave eshte marre me qira nepermjet kontrates Nr. Koleksiom 326/1, Nr. Repertori 1137, se nenshkruar midis qiradhenesve z. Sokol Agaraj, Dr.Nexhat Miftari dhe Dr.Hans-Jakob Limbach me qiramarrresin Shoqeria “Labor Dr. Limbach Heidelberg Germany” sh.p.k.

Laboratori mjekesor Labor Dr Limbach Heidelberg Germany ndodhet ne Jug-Perendim te Qytetit te Tiranës, ne rrugen “Tish Daija”, Kompleksi Kika 2 sipas koordinatave ne sistemin Albanian 1987 / Gauss-Kruger zone 4 : E 4400055.63, N 4576572.10




Vendodhja e aktivitetit



3/17/2022, 9:54:22 AM
Rrjeti Rrugor i Propozuar
D. Rruge Urbane Kryesore
E. Rruge Urbane Dytesore

Ortofoto I Vendodhja e aktivitetit

Objekti sipas Planit te Pergjithshem Vendor ndodhet ne Njesine Strukturore: TR/106
Bashkia Tirane
Sistemi UB_Urban
Kategoria 1 A. Banim 90%
Kategoria 2 AS. Arsim 7%
Kategoria 3 IN. Infrastruktura 3%



KUADRI LIGJOR

Ne vijim te raportit do te njihemi me ligjet baze te cilat detyrojne me forcen ligjore mbrojtjen e mjedisit. Subjeti zhvillues eshte ne zbatim te hapave ligjore.

Ligje

Ligji Nr.10431, date 09.06.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit" i ndyshuar

Ligji Nr.52/2020, per disa ndryshime ne ligjin Nr.10 448, date 14.7.2011, "Per lejet e mjedisit", te ndryshuar.

Ligji Nr.10440, date 23/01/2003 "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis"

Ligji Nr.12/2015 date 26.2.2015 Per disa ndryshime ne ligjin nr. 10 440, date 7.7.2011, "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis"

Ligji Nr. 10448, date 14/07/2011,"Per lejet e mjedisit",

Ligji Nr.8897, date 16/05/2002, "Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja"

Ligji Nr.9774, date 12/07/2007, "Per vleresimin dhe administrimin e zhurmes ne mjedis"

Ligji Nr.9010, date 13/02/2003, "Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta"

Ligji Nr.9587, date 20/07/2006, "Menaxhimin e integruar te burimeve ujore "

Ligji Nr. 10081, date 23.02.2009 "Per licencat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise", ndyshuar me ligjin nr.10.137, date 11.05.2009.

Ligji Nr. 8405, date 17/09/1998 "Per urbanistiken" ndryshuar me ligjet Nr. 8453, date 04/02/1999 dhe Nr.8991, date 23/01/2003 dhe Nr.8682, date 07/11/2000"

Ligji Nr. 8652, date 31/07/2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore."

Ligji Nr. 9244, date 17/06/2004 "Per mbrojtjen e tokes bujqesore"

Vendime te Keshillit te Ministrave (VKM) dhe udhezime

VKM Nr.798, date 29.9.2010 "Per miratimin e rregullores per administrimin e mbetjeve spitalore"

VKM Nr.249, date 24.04.2003 "Per miratimin e dokumentacionit per leje mjedisore dhe te elementeve te lejes mjedisore"

VKM Nr.268, date 24.04.2003 "Per certifikimin e specialisteve, per vleresimin e ndikimit ne mjedis dhe te auditimit mjedisor."

VKM Nr.805, date 4.12.2003 "Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis, per te cilat kerkohet Leje Mjedisore.

VKM Nr.24, date 22.01.2004 "Per veprimtarine e inspektoriatit te mjedisit"

VKM Nr.177, date 31.03.2005 "Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret.

VKM Nr.686, date 29.7.2015 "Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis (vnm) dhe procedures se transferimit te vendimit e deklarates mjedisore.

Udhezim i Ministrit te Mjedisit Nr.3, date 17.08.2004 "Per miratimin e listes se veprimtarive, formatimin e aplikimit, dhe rregullat e procedurat e dhenies se pelqimit dhe autorizimit mjedisor nga ARM.

Rregullore e Ministrise se Mjedisit Nr.1, date 17.08.2004 "Per pjesemarrjen e publikut ne procesin e vleresimit te ndikimit te mjedis."

Udhezimi i Ministrit te Mjedisit Nr.5, date 28.12.2007 "Per tarifat e sherbimit per Leje Mjedisore.

Udhezim i Nr.2, date 21.05.2007 "Per miratimin e listes se veprimtarive me ndikim ne mjedis, menyren e aplikimit dhe rregullat e provedurat e dhenies se autorizimit dhe pelqimit mjedisor nga Agjencite Rajonale te Mjedisit".

Udhezim i Ministrit te Mjedisit Nr.1, date 07.01.2008 "Per dokumentacionin e domosdoshem per te kerkuar leje mjedisore.

Urdher i Ministrit te Mjedisit, Nr.429, date 17.11.2009 "Per rregullat dhe procedurat per pajisjen me leje mjedisi ne kuader te Qendres Kombetare te Licensimit.

PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

Laboratori “Labor Dr. Limbach Heidelberg Germany” sh.p.k eshte nje nga labororet me te mire ne Shqiperi, i cila ka sjell perdorimin e nje teknologjie te re me pajisjet me te avancuara ne fushen e mjeksise laboratorike, duke ofruar sherbime laboratorike mjeksore (analiza mjeksore) te shpejta dhe cilesore per pacientet, me nje staf te trajnuar dhe te specializuar ne kete fushe.

Ky aktivitet zhvillohet ne nje siperfaqe totale rreth 420 m², ne te cilen ndodhen:


- Ambjentet ku jane instaluar pajisjet laboratorike te analizave
- Ambjentet higjeno-sanitare
- Ambjentet e marjes se mostrave
- Ambjentet e pritjes se pacienteve (sporteli)
- Zyra

Me poshte po paraqesim dhe planvendosjen e ambjentit ku eshte instaluar aktiviteti.



Foto 1 Pamje nga laboratori mjeksor

PLANIMETRI KUOTA +/-0.00



Dibuat/desain/diarsip
Maka
Date: 2010/04/20 13:28:11
Vanglueh
Mbrtce

L Labor Dr. Limbach
HEIDELBERG, GERMANY
Rr. Tish Daija, Kompleksi Kika 1, Tirane
NUIS: M 02004008 I

7

Teknologjia

Ne bashkepunim me Siemens Healthineers Diagnostic GmbH eshte instaluar Atellica Solution System, i cili perbehet nga i. **Atellica® IM 1600 Analyzer**; ii. **Atellica® CH 930**; iii. **Atellica® Sample Handler Prime inkl. Magline**;

1. Atellica IM

Teknologjia baze e reaksioneve ne Atellica® Immunoassay analyzer eshte kemiluminishenca. Kemiluminishesenca eshte nje reaksion kimik qe emeton energji ne forme te drites; drita qe prodhon reaksioni tregon sasine e analitit ne moster.

2. Atellica CH

Teknologjia baze e reaksioneve ne Atellica® Chemistry analyzer perfshin 2 tipe madhore.

- Fotometrine
- IMT (Integrated Multisensor Teknologji)

Kapaciteti realizimit te testeve eshte deri ne 1800 teste/ore per sa i perket fotometrise dhe deri ne 600 teste/ore per sa i perket analizave imunologjike.

3. ADVIA 2120i. Heamatology Systems

Sistemi i Hematologjise ADVIA® 2120i automatizon laboratorin e hematologjise pa nevojën e sistemeve te medha. Rregullon rrjedhen e punes dhe maksimizon produktivitetin me nje analizues te hematologjise qe eliminon shumicen e hapave manuale qe kryhen zakonisht.

Advia 2120i Heamatology System eshte nje pajisje diagnostike plotesisht e automatizuar. Analizatori perdor si moster gjakun e plote per te dhene rezultatet e meposhtme:

- Gjak komplet
- Gjak komplet plus diferencimi i rruazave te bardha
- Gjak komplet/dif.rruazave te bardha plus retikulocit
- Gjak komplet / retikulocit

4. CLINITEK Novus Pro System

Clinitek Novus eshte nje paisje teresisht automatike qe mundeson analizimin e vetive biokimike dhe fizike te urines.

CLINITEK Novus® Analyzer kombinon teknologjine e kimise se urines me pluhur te thate dhe nje format te proves se kasetes per te ndihmuar ne sigurimin e produktivitetit maksimal dhe testimin e standardizuar me analizuesit e tjere CLINITEK®.

Duke ofruar nje spekter te plote provash dhe nje kapacitet deri ne 240 mostra /ore, ai rregullon rrjedhen e punes, thjeshton testimin dhe jep rezultate te qendrueshme, me cilesi te larte.

Kapaciteti perpunimit te tubave te urines eshte deri ne 100 tuba urine ore.

5. Sysmex CA-600 Automated Blood Coagulation Analyzer

Sysmex CA-600 Automated Blood Coagulation Analyzer eshte nje pajisje plotesisht e automatizuar per kryerjen e testeve te koagulimit. Metodat baze te realizimit te testeve jane:

- Clotting method

- Metoda kromogjenike
- Metoda imunologjike

Mostra kryesore me te cilen kryhen analizat eshte plasma, e perftuar nga gjaku ku eshte shtuar antikoagulanti sodium citrate.

Kapaciteti i perpunimit te testeve eshte deri ne: PT-60 teste/h; D-Dimer-16 teste/h; PT, APTT, Fibrinoogen-48 simultaneous teste/h; PT/APTT/Fibrinogen/AT-40 simultaneous tests/h

6. GEMINI Combo

Gemini eshte nje pajisje plotesisht e automatizuar e cila kryen teste imunologjike me metoden ELISA. Reagentet qe perdoren jane ready to use dhe reaksionet kryhen ne nje pjate, e cila eshte pjese e kitit dhe qe eshte e impenjuar (e veshur) me antigene ose antitropa. Kapaciteti perpunimit te testeve per kete pajisje eshte deri ne 20 teste ELISA ne ore.

7. Sebia MINICAP

Sistemet Sebia perdorin parimin e elektroforezes kapilare (CE) ne tretesire te lire. Molekulat e ngarkuara ndahen nga levizshmeria e tyre elektroforetike ne nje pH specifik ne nje mjedis alkaline. Ndarja ndodh sipas pH te elektrolitit dhe rrjedhes elektroosmotike.

Pajisja e elektroforezes kapilare, Sebia (CE) MINICAP, eshte nje pajisje plotesisht e automatizuar e cila mundeson ndarjen e shpejte te proteinave me rezolucion te larte. Kapaciteti 20 samples/h-(Protein); 8 samples/h-(HbA1c and Hb); 10 samples/h- (CD).

8. LIAISON MDX

LIAISON® MDX eshte nje pajisje real-time Polymerase Chain Reaction (PCR) qe perdoret per identifikim te acidit nukleik nga mostrat biologjike. Instrumenti perdor disqe te vecante ku vendoset dhe perpunohet mostra.

Instrumenti perdor dedektimin fluorometrik ne kohe reale per te identifikuar sekuencen target brenda "well-eve" ku hidhet mostra.

Parametrat e funksionimit te instrumentit kontrollohen nga perdorimi i nje kompjuteri te jashtem dhe softuerit perkates. I gjithë reaksioni zhvillohet ne dy well-e. Ne njerën prej tyre hidhet reagenti dhe ne tjetren mostra. Wellet mbyllet hermetikisht (duke mos perbere asnje rrezik per ambientin perreth).

Kapaciteti perpunimit eshte 8 teste/h per Amplification disc 8 welle dhe 96/h per amplification disc me 96 welle.


Lenda e pare: Kjo veprimtari specifikohet si aktivitet sherbimi ne te cilen nuk perfshihen procese prodhimi. Ofrimi i sherbimeve per kryerjen e analizave te ndryshme laboratorike kryhet nepermjet pajisjeve farmaceutike si shiringa, epruveta, etj, te cilat sherbejne per marjen e motrave te gjakut, urines, etj.

Lendet ndihmese:


- Pajisjet farmaceutike per marjen e mostrave te gjakut, urines, koprokultures, etj,
- Reagentet kimik per kryerjen e analizave,
- Energjia elektirke per venien ne pune te makinerive,
- Uji, etj.

Foto te pajisjeve dhe aparaturave ku kryhen proceset

i. Atellica® IM 1600 Analyzer; ii. Atellica® CH 930; iii. Atellica® Sample Handler Prime inkl.Magline;




Atellica CH



ADVIA 2120i. Heamatology Systems



CLINITEK Novus Pro System




Sysmex CA-600
Automated Blood Coagulation Analyzer



GEMINI Combo







Sebia MINICAP



LIASON MDX




Pamje te aktivitetit brenda dhe jashte objektit





JL Labor Dr. Limbach Heidelberg Germany



PLAN-SKEMA TEKNOLOGJIKE DHE VENDOSJA E PAJISJEVE NE LABORATOR SH 1:100

INFRASTRUKTURA

- **Energji elektrike**

Furnizimi me energji elektrike i Labororit Labor Dr Limbach Heidelberg Germany kryhet nga rrjeti kryesor i energjise elektrike te zones nepermjet kontrates Nr. O 039853 qe subjekti ka nenshkruar me OSHEE. Sasia energjise qe konsumohet mesatarisht ne muaj nga kryerja e proceseve ne kete aktivitet eshte 6000-8000 kwh.

- **Uji**

Furnizimi me uje i Labororit Labor Dr Limbach Heidelberg Germany kryhet nga rrjeti kryesor i furnizimit me uje te pijshem te zones nepermjet kontrates me Kod Klienti 43471-1 qe subjekti ka nenshkruar me Ujesjelles Kanalizime Tirane Sh.A. Sasia e ujit qe konsumohet mesatarisht ne muaj eshte 18-20m³/muaj.

Uji ne kete aktivitet pervecse perdoret ne ambientet higjeno-sanitare, perdoret edhe per proceset e kryerjes se analizave laboratorike duke ju nenshtruar paraprakisht trajtimit te tij ne nje pajisje te vecant (pastrimi nga ngarkesat bakteriale dhe elementet kimik).

- **Uji i ndotur**

Largimi i ujrave te ndotura te gjeneruara nga ambientet higjeno-sanitare pasi grumbullohen nepermjet instalimeve hidraulike te kryera ne tualete shkarkohen ne rrjetin e kanalizimeve te zones.

- **Menaxhimi i mbetjeve**

Mbetjet me natyre urbane qe gjenerohen nga aktiviteti jetesor i punonjesve ku perfshihen plastika, qelqi, metali, etj. Keto mbetje grumbullohen nepermjet koshave qe ndodhen ne ambientet e aktivitetit dhe prej andej do te transportohen drejt vendit te depozitimit te mbetjeve urbane.

Mbetjet qe gjenerohen nga kryerja e proceseve te analizave laboratorike te cilat klasifikohen sipas katalogut shqiptar si mbetje spitalore, pasi grumbullohen ne ambientet e aktivitetit nepermjet koshave te posacem merren nga kompania e licencuar per trajtimin e mbetjeve te rrezikshme spitalore MEDI-TEL me te cilen subjekti ka lidhur kontrate me Nr. Serie 220063 date 04.01.2022. Sasia e mbetjeve spitalore qe gjenerohet nga ky aktivitet eshte mesatarisht 12-16kg/muaj.

VLERSIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS

Vleresimi i ndikimeve negative ne mjedis analizohet gjate fazes se funksionimit te aktivitetit "Laboratore Klinik-Biokimik, Mikrobiologjik, Hormonal dhe Gjenetike"..

Vleresimi i impakteve kryhet ne baze te teknologjise qe operone ky subjekt. Ne vijim do te studjojme impaktet negative qe implementohen nga ky aktivitet per parametra te ndryshem mjedisore.

- **Ndikime ne ajer**

Nga zhvillimi i aktivitetit ne te cilin ofrohen sherbime laboratorike mjeksore (analiza mjeksore) nuk kemi gjenerim te pluhurave per faktin se nuk perfshin procese prodhimi. Te gjitha makinerite dhe pajisjet ne te cilen kryhen analizat mjekesore te mostrave te mara nuk emetojne pluhura ne mjedis.

Gjithsesi te gjitha ambjettet e labororit jane te pajisura me sistem ajrimi te nje teknologjie te fundit duke ofruar pacienteve dhe personelit pasterti dhe cilesi te mire te ajrit.

Keto ambiente dezinfektohen ne menyre periodike duke ju permbajtur kushteve higjenike.

- **Ndikime ne uje**

Nga zhvillimi i aktivitetit ne te cilin ofrohen sherbime laboratorike mjeksore (analiza mjeksore) nuk kemi shkarkime ne ujra sipërfaqesore dhe nentokesore. Ujrat e perdorur qe gjenerohen specifikohen si ujra te ndotur urbane nga ambientet higjeno sanitare te cilat perdoren nga punonjesit dhe pacientet qe vijne per sherbimet qe ofrohen ne kete aktivitet.

Keto ujera transportohen nepermjet sistemit hidraulik te instaluar ne ambientet e laboratorit ne puseten e grumbullimit te ujrave te ndotura urbane e cila ndodhet ne afersi te objektit dhe prej andej shkarkohen ne sistemin e kanalizimit te qytetit te Tiranës.

- **Prodhimi i mbetjeve**

Nga zhvillimi i aktivitetit ne te cilin ofrohen sherbime laboratorike mjeksore (analiza mjeksore) nuk do te kete shkarkime ne toke. Ndikime ne toke do te kete ne rastin e mos menaxhimit dhe trajtimit te mbetjeve qe gjenerohen dhe hedhja e tyre ne menyre te pa kontrolluar ne ambientet jashte aktivitetit.

Mbetjet qe gjenerohen nga ky aktivitet jane:

- Mbetjet me natyre urbane qe gjenerohen nga aktiviteti jetesor i punonjesve ku perfshihen plastika, qelqi, metali, etj. Keto mbetje grumbullohen nepermjet koshave qe ndodhen ne ambientet e aktivitetit dhe prej andej do te transportohen drejt vendit te depozitimit te mbetjeve urbane.
- Mbetjet qe gjenerohen nga kryerja e proceseve te analizave laboratorike te cilat klasifikohen sipas katalogut shqiptar si mbetje spitalore, pasi grumbullohen ne ambientet e aktivitetit nepermjet koshave meren nga kompania e licencuar per trajtimin e mbetjeve te rrezikshme spitalore MEDI-TEL me te cilen subjekti ka lidhur kontrate me Nr. Serie 220063 date 04.01.2022. Sasia e mbetjeve spitalore qe gjenerohet nga ky aktivitet eshte mesatarisht 12-16kg/muaj.

- **Emetimi i zhurmave**

Ky aktivitet nuk eshte burim i gjenerimit te zhurmave per vete faktin e sherbimeve te cilave ofron. Makinerite dhe pajisjet ne te cilat kryhen proceset e analizave nuk gjenerojne zhurma. Te vetme zhurma qe gjenerohen mund te jene bisedat qe vijne nga pacientet me njeri tjetrin dhe mjekun. Keto zhurma jane te pa perfillshme pasi ne laborator zbatohen rregulla per respektimin dhe mbajtjen e qetesise.

- **Prani te zjarrit**

Prani te zjarrit mund te kemi vetem si pasoj e shendijave elektrike, por subjekti ka mare duke instaluar sistemin e alarmit per renien e zjarrit dhe sistemin kundra zjarrit ne te gjitha ambientet e aktivitetit.

MASAT E PROPOZUARA PER MBROJTJEN E MJEDISIT

Identifikimi i masave per te eliminuar apo zbutur ndikimet negative ne mjedis

a) Planifikimi i zones

Zhvillimi i aktivitetit behet sipas planit duke ruajtur radhen e punes per kryerjen e sherbimeve, marjen e mostrave nga pacientet, kryerja e proceseve te analizave, grumbullimin dhe diferencimi i mbetjeve sipas specifikimeve urbane dhe spitalore, dhe transportin e tyre drejt destinacionit perkates. Rekomandohet mbjellja e bimesise duke ju pershtatur ambjenteve te brendshme te laboratorit

b) Masat teknike

Per nje ecuri sa me te mire te proceseve per kryerjen e sherbimeve te permendura me sipër nga ky aktivitet, ne subjekt parashikohet te ndiqen masat e propozuar:

- Kontroll te makinerive dhe pajisjeve qe kryejne proceset e analizave.
- Pastrim, lyerje dhe riparim te mjediseve te brendshme dhe te ambjenteve.
- Dezinfektim te makinerive, pajisjeve dhe ambjenteve te punes ne menyre periodike.

c) Masat konkrete per administrimin e mbetjeve te ngurta

Per administrimin e mbetjeve qe do te gjenerohen, duhet te marre keto masa:

- Mbetjet qe gjenerohen nga punonjesit, duhet te largohen ne menyre korekte nga ambjentet e punes dhe te dergohen drejt destinacionit perkates.
- Mbetjet qe gjenerohen nga proceset e analizave laboratorike mjekesore te klasifikuar si mbetje spitalore pasi grumbullohen ne ambjentet e laboratorit te largohen ne menyre periodike nga kompania e licensuar per trajtimin tyre.

d) Masat konkrete per mbrojtjen e cilesise se ajrit

Me qellim qe shkarkimet ne ajer qe emeton aktiviteti te jene vazhdimisht brenda normave te lejuara duhet te merren keto masa keto masa:

- Ambjentet rreth e rrotull aktivitetit duhet te pastrohen ne menyre periodike per te shmangur ngritjen e pluhurave nga levizja e pacienteve.
- Te kryhet ventilimi i ambjenteve ku kryhen sherbimet laboratorike dhe proceset e analizave.
- Mbjellje bimesi dekorative qe ju pershtaten ambjenteve te brendshme per pastrimin e ajrit.

Vleresimi i efektivitetit te pritshem te masave zbatuese

Realizimi i objektivave dhe treguesve te pritshem te parashikuar ne projekt do te varet nga respektimi i te gjitha treguesve te percaktuar. Kontrolli, monitorimi dhe permirsimi i vazhdueshem, sipas kushteve teknike te punes ne zbatim te projektit, qe do te coje perfundimisht perfitimin e pamjeve te parashikuar ne projekt me siperfaqe te brendshme te sistemuara dhe me oborr te gjelberuar aty ku do te kete hapsira te lira.

Plani i emergjencave

Plani i emergjencave eshte nje nder planet kryesore me qellim parandalimin dhe mbrojtjen e jetes dhe shendetit te punonjesve, komunitetit dhe mbrojtjen e mjedisit. Personeli i ketij projekti duhet te njohe mire te gjitha proceset qe kryhen ne kete projekt ne menyre qe te arrije te kuptoje situaten, shkaqet dhe te jete i pergatitur per menaxhimin e avarive apo aksidenteve. Ne rast se gjendemi para nje aksidenti personat me te afert duhet te japin shenjen e alarmit. Ne varesi te llojit dhe madhesis se aksidentit do te kryhet izolimi.

Masat per parandalimin e avarive dhe aksidenteve ne frontin e punes jane:

- Perdorimi i mjeteve dhe paisjeve te cilat jane ne gjendje te mire teknike
- Servisim periodik i pajisjeve dhe makinerive ne frontin e punes
- Çdo person para se te nisi punen ne kete projekt ti nenshtrohet trajnimit per te njohur gjitha procesin teknologjik, per tu njohur me rrezikun e aksidenteve dhe reagimin e tij ne cdo rast emergjent.
- Ne objekt te ndertohet kendi i ndihmes se shpejte dhe te jete i njohur nga te gjitha personat e punesuar.
- Ne objekt te vendosen tabela/njoftime ku tregohen pikat kyçe te rrezikut, te publikohen numrat e kontaktit te supervisorit te emergjencave.
- Zona te jete e rrethuar per te evituar hyrjen e personave te pa autorizuar.
- Te jete ndertuar sistemi i tokezimit

Aksidentet më të shpeshta në laborator

A.Në marrjen e gjakut mund të ndodh që stafi i laboratorit të shpohet me agen e pacientit, apo edhe nga kontakti fizik me pacientin mund të ndodh infektimi nga sëmundje të ndryshme infektive.

1. Masat për parandalimin e infektimit në dhomën e marrjes së mostrave janë mundësuar nga punëdhënësi:

- Doreza një përdorimshme
- Maska Kirurgjikale
- Kostumi i punës
- Përparëse
- Shapka ose qese këpucesh një-përdorimshe
- Dezinfektant
- Sapun/Ujë të rrjedhshëm për larjen e duarve
- Kutia e ndihmës së shpejtë.

B.Kontaminimi nga lëndët biologjike: Kontaminim nga serumi / gjaku / urina / feçe pra nga mostat e pacientëve. Kontaminim nga koshat e posaçëm për mbetjet spitalore. Çlirimi i lëndëve të dëmshme nga mbetjet biologjike.

2. Masat për parandalimin e infektimit në këtë rast janë:

- Doreza një përdorimshme
- Maska Kirurgjikale
- Dezinfektant
- Sapun/Ujë të rrjedhshëm për larjen e duarve
- Dezinfektant për duart
- Dezinfektant për tavolinat e punës
- Ambient i posaçëm për derdhjen e lëngjeve biologjike
- Kosha të posaçëm për mbetjet infekte
- Ambient i dedikuar për vendosjen e koshave të verdhë të mbetjeve infekte.
- Postera dhe Etiketa për çdo vend pune në mënyrë që çdo gjë të jetë e identifikueshme.

Bëhen nga laboratori testet virusale dhe check up, një here në vit për të gjithë personelin.

Zonat e punes ne laborator

- Ne laborator duhet te mbahet pasteri dhe rregull, duke eliminuar te gjitha materialet e panevojshme per punen qe zhvillohet ne laborator.
- Siperfaqet e punes duhet te dizinfektohen pas çdo derdhje materialesh potencialisht te rrezikshem dhe ne fund te dites se punes.
- Paketimi dhe transportimi duhet te behet sipas regullave kombetare dhe nderkombetare.

Trainimi i Personelit

- Trainimi do te mbuloje aspektet e shendetit dhe sigurise gjate kryerjes se proceseve te punes. Trainimi mjedisor do ti referohet kushteve aktuale mjedisore, ndikimeve potenciale mjedisore te punes qe do te behet dhe zbatimit te masave specifike parandaluese per eliminimin apo minimizimin e ndikimeve negative.
- Nje plan trainimi do te zhvillohet per te siguruar se personeli perkates ka marre trainimin e duhur dhe kompetencat per kryerjen e punes se tij.
- Trajnim i stafit për ndihmën e shpejtë bëhet sipas dokumentit bashkëngjitur për trajnimin për ndihmën e shpejte dhe çdo punonjës i ri trajnohet sipas këtij dokumenti. Në pikat kyçe dhe vende të dukshme e të aksesueshme të laboratorit vendosen numrat e emergjencës për çdo rast emergjence.

Subjekti është i detyruar që në rast aksidentesh të njoftojë institucionet përkatëse për menaxhimin e situatave me qëllim zvogelimin e impakteve mjedisore dhe rrezikut që mund të preke jetën e punonjësve apo dhe banorëve.